



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 331 Akti

Nr. 253 Vendimi
Tiranë, më 12.3.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu kryesuese

Olsi Komici anëtar

Genta Tafa (Bungo) relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 12.3.2020, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Nevrie Duka (Halo)**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJY KUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, aktualisht me funksionin gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 12.11.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Suela Zhegu dhe z. Olsi Komici. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 18.11.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Nevrie Duka.

5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe; Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

¹ Me shkresën nr.***prot., datë 22.02.2019.

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- c) ka mosdeklarime të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

8. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në datën 28.2.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruar nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurës Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

9. Subjekti i rivlerësimit, në datën 28.2.2020, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

10. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 2.3.2020 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve, pa sjellë prova të reja në momentin e njohjes me dosjen.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore².

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 9.3.2020.

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 12.3.2020, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Theo Jacobs.

14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Nevrie Duka, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

15. Në përfundim të fjalës së saj, subjekti i drejtoi trupit gjykues dy pyetje³. Së pari, nëse ky trup gjykues legjitimohet të kryejë edhe hetimin, edhe gjykimin për procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, si dhe nëse është hetuar edhe për dy kriteret e tjera: atë të figurës dhe kriterin profesional. Duke qenë subjekti nuk paraqiti formalisht kërkesë, bazuar në nenin 49 të ligjit 84/2016, Komisioni iu përgjigj menjëherë pyetjeve, duke sqaruar se, në lidhje me pyetjen e parë, përgjigjen e jep Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Aneksi i saj, ndërsa në lidhje me pyetjen e dytë, përgjigjja i është dhënë subjektit me anë të *e-mail*-it të datës 3.3.2020.

²Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 9.3.2020.

³Për më shumë, shiko procesverbalin e seancës dëgjimore.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Znj. Nevrie Duka ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, por përgjigjet e saj nuk kanë qenë të plota e sqaruese për trupin gjykues.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe shpjegimet gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

VLERËSIMI I PASURISË

20. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Hetimi i kryer nga Komisioni është

⁴“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlersimit të subjekteve të rivlersimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlersimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

21. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

22. Aktualisht posedoj një apartament (ku jetoj prej qershorit të vitit 2010), ndodhur në L.1, rr. “****”, pall. ***, k. ***, me pronar J.B., me të cilin bashkëshorti im ka bërë një marrëveshje verbale, që në këmbim të vlerës së punës së gërmimit për pallatet e tij, të na japi këtë apartament. Akoma s’kemi bërë hipotekimin. Zotëroj 50%.

Subjekti nuk ka dorëzuar dokumente provuese.

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor (kontratë përdorimi/marrëveshje) për posedimin e apartamentit në lagjen nr.***, rr. “****”. Gjithashtu, është i dyshimtë fakti i posedimit të apartamentit prej vitit 2010, pa asnjë dokumentacion ligjor.*
- *Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për punën e kryer (punime gërmimi) nga bashkëshorti i subjektit për shtetasin J.B., dhe vlerën e këtyre punimeve, në këmbim të së cilës i është dhënë apartamenti.*
- *Është e paqartë kryerja e punimeve të gërmimit nga bashkëshorti, pasi QKB-ja dhe organet tatimore nuk konfirmojnë aktivitetet të licensuar për kryerjen e tyre.*

Arsyetimi ligjor

22.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar se ka në posedim një apartament, por pa vendosur në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për posedimin e këtij apartamenti.

22.2 Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar: (i) sipërfaqen e apartamentit; (ii) vlerën në lekë /çmimin e blerjes, kërkesa këto, të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

22.3 Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë dokumentacion provues për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave të saj për përfitimin e këtij apartamenti. Ajo ka deklaruar si burim një marrëveshje verbale midis bashkëshortit të saj dhe pronarit J.B., që në këmbim të vlerës së punës së gërmimit për pallatet e tij, t’i jepej një apartament. Ky deklaram i subjektit nuk është i mbështetur në prova, sikundër kërkohet nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 32/1 i ligjit nr. 84/2016.

22.4 Subjektit i është kërkuar gjatë hetimit të depozitohet dokumentacion provues në lidhje me këtë pasuri. Nga ana e saj sërish nuk është depozituar asnjë dokument për të provuar posedimin e këtij apartamenti dhe burimin e ligjshëm të ardhurave për përfitimin e tij. Subjekti, për të provuar deklaratimet e saj, ka bashkëlidhur deklaratën noteriale nr. *** datë 29.1.2020.

22.5 Në këtë deklaratë, znj. M.B., deklaroi se: “Unë M.B., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k deklaroj me përgjegjësi të plotë se, në vitin 2010 me z. E.D., kemi bërë një marrëveshje që kundrejt vlerës së punimeve të gërmimit që ai do të kryente me mjetin e tij “skrep” në objektet që do të ndërtoheshin nga shoqëria në qytetin e Sarandës, të përfitonte një apartament...Është fakt që pas vitit 2011 shoqëria nuk është pajisur me leje ndërtimi për të ndërtuar objekte...dhe për këtë arsye që prej vitit 2011 si shoqëri nuk na është dhënë

mundësia që t'i japim ndonjë porosi z. E.D., për të kryer gërmime...Nëse shoqëria deri në 30.12.2021 nuk merr leje ndërtimi, atëherë do të bëjmë një marrëveshje të re për të përcaktuar mënyrën e likuidimit të çmimit të apartamentit prej 38, 000 euro.”

22.6 Siç rezulton nga sa më lart, bashkëshorti i subjektit, ndryshe nga sa deklaroi subjekti në deklaratën “Vetting”, por dhe gjatë këtij procesi⁵, nuk ka kryer asnjë punim për shoqërinë “***”. Ky fakt konfirmohet dhe nga vetë shoqëria “***” me shkresën e datës 19.2.2020, në të cilën deklarohet se z. E.D., nuk ka qenë asnjë ditë i punësuar pranë shoqërisë së mësipërme, qoftë si nënkontraktor, qoftë si punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë.

22.7 Në lidhje me fillimin e banimit në këtë apartament, subjekti, në formularin e kontrollit të figurës, ka deklaruar se ka jetuar duke filluar nga qershori i vitit 2009. Bazuar në librezën e UKT-së rezulton se pagesat për këtë apartament kanë filluar që në qershor të vitit 2009 dhe janë paguar në datën 8.8.2014.

22.8 Bazuar në shkresën nr. ***, datë 24.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, rezulton se subjekti ka dhënë vendim datë 25.9.2013, duke rrëzuar padinë kundër të paditurit, shoqëria “***” sh.p.k., administratore e së cilës është M.B. Subjekti, bazuar në nenin 72 të K.Pr.Civile nuk duhej të gjykonte këtë çështje, pasi ajo ka përfituar apartament nga shoqëria “***”, administratore e së cilës është M.B.

22.9 Në përfundim të hetimit⁶ të kryer nga Komisioni, nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit, ka rezultuar se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” vlerën e apartamentit, si dhe sipërfaqen e tij; (ii) deklarimi i subjektit në deklaratën e kontrollit të figurës nuk përputhet me deklarin e saj në deklaratën “Vetting” për sa i përket kohës së fillimit të banimit të subjektit në këtë apartament; (iii) deklarimet e subjektit në lidhje me punimet e kryera nga bashkëshorti i saj nuk përputhen me deklaratën noteriale të znj. B., deklaratë kjo e depozituar nga vetë subjekti.

22.10 Ndërsa në vlerësim të dokumentacionit të administruar ka rezultuar se: (i) subjekti nuk provon me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave për përfitimin e këtij apartamenti; (ii) subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument ligjor për të provuar posedimin e këtij apartamenti nga ana e saj; (iii) subjekti nuk e ka deklaruar posedimin mbi këtë apartament në asnjë nga deklaratat periodike; (iv) rezulton e dyshimtë marrëdhënia juridike e subjektit me këtë pasuri; (v) subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit.

Për të gjitha këto rezultate të hetimit, subjekti iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

22.11 Në parashtrimet e veta, subjekti ka pretenduar se ka deklaruar vlerën dhe sipërfaqen e apartamentit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga ana e Komisionit, por subjekti nuk ka sqaruar pse këto të dhëna nuk janë paraqitur në deklaratën “Vetting”, detyrim ky qartësisht i parashikuar nga ligji.

22.12 Në lidhje me punimet e gërmimit të kryera nga bashkëshorti i saj, si pasojë e të cilave do të përfitonte këtë apartament, subjekti parashtron se vërtet këto gërmime nuk janë kryer, por janë kryer punime sistemimi “sa për të justifikuar fillimin e punës”.

22.13 Megjithëse (i) subjekti e pranon faktin që nuk janë kryer gërmime dheu sipas marrëveshjes; (ii) marrëveshja midis palëve parashikon se apartamenti do të përfitohet duke

⁵ Shih pyetësorët nr.1, 2,3.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Kthim përgjigjeje Drejtoria Vendore Sarandë (ASHK) nr. *** prot., datë 31.12.2019

Ilogaritur vlerën e punimeve për gërmimin e dheut; (iii) administratorja e shoqërisë pranon faktin se këto gërmime nuk janë kryer, meqenëse shoqëria nuk është pajisur me leje ndërtimi që nga viti 2011 e deri më sot; (iv) organet tatimore nuk konfirmojnë regjistrimin e kësaj marrëveshje midis E.D., dhe “****”; (v) organet tatimore nuk konfirmojnë tatime të paguara as nga zoti D., e as nga “****” për llogari të kësaj marrëveshjeje, subjekti nuk ka provuar në asnjë moment lidhjen e pronësisë me këtë pasuri, madje në parashtrimet e paraqitura në vijim të barrës së provës, subjekti shprehet se nuk e ka të qartë se ku qëndron dyshimi i Komisionit në lidhje me marrëdhënien ligjore të tij me këtë pasuri.

22.14 Në lidhje me konfliktin e interesit, rezultat i hetimit, subjekti ka pretenduar se një shkresë e dytë⁷ e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, vërteton faktin se ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi.

22.15 Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë “apartament”, të ndodhur në rrugën “****”, Sarandë; (ii) subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor të drejtën e pronësisë mbi këtë apartament; (iii) Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë këtë pasuri. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61 pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

23. Apartament⁸, në emër të vajzës, O.D., me sipërfaqe 100.2 m², regjistruar me numër pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Tiranë, vlera 45, 000 euro. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Blerë me një pjesë të shumës së nxjerrë nga shitja e tokës 400 m².

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Vlerë e ulët dhe e dyshimtë e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 100.2 m², me adresë ***, Tiranë, në vitin 2012 në vlerën 45,000 Euro, krahasuar me tregun.*
- *Mosdeklarim i destinacionit të përdorimit të shumës 70,000 euro me burim nga shitja e truallit me sipërfaqe 400 m², në Sarandë, në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2008, shumë e cila pjesërisht është përdorur për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 100.2 m², ***, Tiranë në vitin 2011.*
- *Rezulton mospërputhje në lidhje me periudhën e likuidimit të shumës 45,000 euro për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi referuar deklaratës së interesave private periodike vjetore 2011, subjekti ka deklaruar blerje apartamenti me vlerë 45,000 euro, ndërsa referuar kontratës së shitjes datë 8.9.2014, çmimi është likuiduar totalisht në vitin 2012.*

Arsyetimi ligjor

23.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni⁹ rezulton se më 8.9.2014 me kontratë shitjeje nr. ***, subjekti së bashku me bashkëshortin kanë blerë në emër të vajzës së mitur, apartament me sipërfaqe 100.2 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale *** ndodhur në ***, Tiranë, vlera 45,000 Euro. **Bazuar në kontratën e shitjes rezulton se çmimi është likuiduar totalisht në vitin 2012.**

23.2 Në lidhje me këtë apartament, gjatë hetimit, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit:

⁷ Shiko shkresën nr. ***, datë 2.3.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

⁸ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) Certifikatë për vërtetim pronësie; (ii) Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.2014

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

- Mandatarkëtimi nr. *** serie, nr. *** datë .././2011, ku rezulton se z. E.D., ka arkëtuar shumën 35, 000 euro me emërtim: *arkëtim kësti ap. ****, *kati ****, *korpusi ****. *Arkëtar E.B.*
- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 8.9.2014, ku rezulton se z. E.D., ka arkëtuar shumën 10, 000 euro me emërtim: *pagesë kësti për ap. ****, *kati ****, *korpusi ****. *Arkëtar E.B.*

23.3 Ky apartament është deklaruar për herë të parë në DVP/2011, në vlerën 45, 000 euro, vit në të cilin është pasqyruar blerja e apartamentit në analizën financiare.

23.4 Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar se janë të ardhura të përfituara nga shitja e tokës truall në Sarandë. (shiko pikën 24 më poshtë.)

23.5 Në tabelën më poshtë është pasqyruar analiza financiare mbi mundësinë e subjektit për të blerë këtë apartament.

	2011
Pasuri	6 097 755
Apartament 100, 2 m ² , në ***, për vajzën O.	6 223 500 ¹⁰
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>-125 745</i>
Likuiditete gjendje	430 523
Të Ardhura dokumentuar	1 080 444
Të ardhura nga paga e subjektit	990 098
Pagë bashkëshorti	75 808
Interesa nga bankat	14 538
Shpenzime	596 700
Shpenzime jetese	409 860
Shpenzime udhëtimi TIMS	11 701
Shlyer këste për kredinë 700,000 lekë	175 139
Mundësia për kursime	-5 614 012

3.6 Duke qenë se (i) apartamenti është deklaruar për herë të parë në DPV/2011, në vlerën 45, 000 euro; (ii) vlera prej 70, 000 euro e përfituar nga shitja e truallit në vitin 2008 nuk rezulton e tatuar; (iii) kjo vlerë e përfituar nga shitja e truallit nuk rezulton e deklaruar gjendje në DPV/2008, por as në ato pasardhëse. Komisioni vendosi që në analizën financiare të vitit 2011 të mos përfshijë si burim për blerjen e këtij apartamenti shumën 70, 000 euro, duke i kaluar barrën e provës subjektit për mungesë të ardhurash të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën 5, 614, 012 lekë.

23.7 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti dha shpjegime, të cilat nuk janë bindëse, pasi nga ana e saj nuk u provua që për shumën 70, 000 euro të jenë paguar detyrimet tatimore, kërkesë kjo e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk provoi që shuma 70, 000 euro ka qenë gjendje në banesën e saj gjatë viteve 2008 - 2011.

23.8 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament të ndodhur në ***, Tiranë, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kuptim të nenit D pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gerrat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61 pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰ Kursi i këmbimit 1 Eur = 138.3 lek, data 31.12.2011, Banka e Shqipërisë.

24. Tokë truall me sipërfaqe 400 m², marrë nga Bashkia Sarandë në vitin 1999 në emër të Nevrie Halo (Duka) dhe shitur me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., datë 28.5.2008 për 70, 000 euro¹¹.

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Përfitimi i truallit, blerë me çmim simbolik nga shteti, me qëllim ndërtim hotel turizmi, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë, nuk përdoret sipas qëllimit të miratuar dhe shitet pas 8 vitesh në vlerën 70, 000 euro (ose 30 herë më shumë).*
- *Është e paqartë kryerja e disa akteve ligjore për përfitimin e shumës 70,000 euro në këmbim të truallit me sipërfaqe 400 m², Sarandë.*

Arsyetimi ligjor

24.1 Nga hetimi¹² konstatohet se me vendim të Këshillit Bashkiak, Sarandë, nr. ***, datë 28.8.1999, subjektit i është dhënë si investitor i sheshit të ndërtimit blloku nr. ***, parcela ***, me sipërfaqe 400 m² me këto kondicione urbanistike-arkitektonike: vija e ndërtimit 3 m², koeficienti i shfrytëzimit të territorit 0.4 m², numri dhe funksioni i kateve mbi tokë 2 - 3 kate, lloji i mbulesës soletë + çati, lartësia e katit tip 3m.

24.2 Në datën 4.9.2000 me kontratë shitblerjeje nr. ***, subjekti ka blerë truallin për shumën 288, 000 lekë.

24.3 Në datën 28.5.2008 është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *** midis subjektit dhe z. Z.H.

24.4 Në datën 18.3.2016¹³ me kontratë shitblerjeje nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka shitur truall me sipërfaqe 400 m² me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, për shumën 70, 000 euro. Në kontratë është përcaktuar se kjo shumë është likuiduar në datën 26.5.2008 e konfirmuar nga deklarata noteriale nr. *** kol., datë 28.5.2008.

24.5 Subjekti, gjatë hetimit, ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore.

24.6 Nga verifikimi i deklaratave periodike rezulton se shuma 70, 000 euro nuk është deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2008, por as në vitet pasardhëse.

24.7 Subjektit i është kërkuar dokumentacion provues për marrjen e shumës 70, 000 euro nga shitja e tokës dhe pagimin e detyrimeve tatimore.

24.8 Meqënëse (i) subjekti nuk kishte paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar dhënien e shumës 70, 000 euro nga z. Z.H.; (ii) subjekti kishte nënshkruar disa akte ligjore për truallin në të njëjtën datë¹⁴; (iii) në asnjë nga aktet noteriale nuk rezulton të ketë nënshkruar z. Z.H., por përfaqësuesi i tij me prokurë; (iv) nuk kishte asnjë provë që të vërtetonte që z. Z.H., dhe subjekti kishin kontaktuar drejtpërdrejt me njëri-tjetrin për të vërtetuar qoftë dhe hipotetikisht dhënien *cash* të shumës 70, 000 euro; subjektit iu kërkuua të justifikonte me dokumentacion burimin e ligjshëm të të ardhurave për z. H. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për sa iu kërkuua.

¹¹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.3.2016; (ii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2008.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

¹³ Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Sarandë rezulton se subjekti ka sipërfaqe truall hotel-turizëm në Sarandë, lagjja nr.***, zona e re Turizëm – Kanali i ***. Kjo pasuri është transkriptuar me kontratën nr. ***, datë 18.3.2016.

¹⁴ Fillimisht kishte nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me nr. ***, datë 28.5.2008 dhe në po të njëjtën ditë deklaratën noteriale nr. ***.

24.9 Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për: (i) dyshime për kontratë fiktive shitblerjeje të këtij trualli, me qëllim justifikimin e shumës prej 70, 000 euro; (ii) shuma prej 70, 000 euro nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, bazuar në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk është deklaruar si gjendje *cash* në DVP/2008; (iii) rezultoni i paqartë përfitimi i truallit me një çmim simbolik nga Bashkia Sarandë në vitin 2000 dhe shitja e tij me një çmim 30 herë më të lartë pas shtatë vitesh, pa kryer asnjë investim në të, sipas kriterit përfitues të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak.

24.10 Në parashtrimet e saj, për të provuar burimin e ligjshëm e të ardhurave të shtetasit Z.H., subjekti ka sqaruar: *“Në momentin që është arkëtuar leku nga ana ime në masën 70, 000 euro, është bërë kalimi në bankë i kësaj shume. Sipas ligjit, kjo shumë, në momentin e kalimit në bankë, i është nënshtruar verifikimit të mëtejshëm, si dhe deklarimit nga ana e bankës në Drejtorinë e Pastrimit të Parave. Kjo shumë është konfirmuar nga kjo drejtori, mbasi nuk e ka konsideruar të ardhura të paligjshme dhe ky është ligjërimi i kësaj shume sipas ligjit.”* Subjekti nuk vuri në dispozicion të Komisionit asnjë dokumentacion provues.

24.11 Në vlerësim të Komisionit, ky arsyetim i subjektit nuk qëndron. Përderisa shuma prej 70, 000 euro është marrë *cash* nga subjekti dhe është depozituar disa muaj më vonë prej tij në “Procredit Bank”, nuk vërtetohen mundësitë financiare të blerësit dhe nuk rrëzohen dyshimet e Komisionit për një kontratë fiktive për të justifikuar këtë shumë. Këto dyshime bëhen edhe më të forta kur dokumentimi i tyre ligjor bëhet me një deklaratë noteriale të datës 28.5.2008, për të provuar se pagesa është bërë më 26.5.2008 dhe kur kontrata e shitblerjes është e datës 18.3.2016. Në të gjitha këto akte nuk rezultoi të ketë firmosur personalisht z. Z.H., por përfaqësues i tij me prokurë, duke mos u provuar në këtë mënyrë pagesa e shumës 70, 000 euro nga z. Z.H., tek subjekti i rivlerësimit.

24.12 Në lidhje me përfitimin e një trualli me çmim simbolik nga Bashkia Sarandë, si investitor, dhe shitjen e tij disa vite me vonë me një çmim 30 herë më të lartë, subjekti ka pretenduar se ky ka qenë çmimi i vendosur nga ana e Bashkisë, ndërsa shitja e tij disa vite më vonë me çmim shumë herë më të lartë është logjike për tregun e Sarandës. Në seancën dëgjimore, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna në parashtrimet e tij me shkrim. Ajo ka sqaruar se “ka përfituar truall nga Bashkia Sarandë, si të gjithë qytetarët e tjerë të Sarandës dhe e ka shitur atë me çmim të lartë, si të gjithë të tjerët”.

24.13 Në përfundim, Komisioni, pasi vlerësoi provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit, konstaton se: (i) subjekti nuk ka paguar detyrimet tatimore për shumën 70, 000 euro, detyrim ligjor i parashikuar nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se z. Z.H., i ka paguar shumën 70, 000 euro; (iii) Subjekti nuk rezultoi të ketë deklaruar gjendje *cash* në shumën 70, 000 euro në vitet 2008 - 2011, por as në vitet pasardhëse; (iv) subjekti nuk provoi mundësitë financiare të blerësit të truallit, z. Z.H. Si rrjedhojë e konstatimeve të mësipërme, shuma 70, 000 euro nuk do të përfshihet si e ardhur për subjektin e rivlerësimit. Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

25. Autoveturë¹⁵ “BMW” *, viti 2006**, në emër të E.D., Nevrie Duka sipas certifikatës së pronësisë së mjetit nr. ***, datë 23.4.2012 (e blerë pas shitjes së autoveturës e markës “Land Rover”). Subjekti nuk ka deklaruar burimin në deklaratën “Vetting”.

¹⁵Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) leje qarkullimi për automjet; (ii) Certifikatë pronësie mjeti; (iii) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2012

Konstatimi i ILDKPI-së:

- Mosdeklarim në deklarinimin e interesave private periodike vjetore 2012, i blerjes së automjetit “BMW”, ***, me targa *** dhe vlerë 12,000 euro.
- Mosdeklarim në deklarinimin e interesave private periodike vjetore 2009 i blerjes së automjetit “Land Rover”, shitjen e tij në deklarinimin e interesave private periodike vjetore 2012, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për blerjen e tij.

Arsyetimi ligjor

25.1 Në datën 12.4.2012, me faturë tatimore nr.105, bashkëshorti i subjektit dhe subjekti kanë blerë automjetin tip “BMW” për shumën 1, 420, 411 lekë. Ky automjet është shitur në datën 17.4.2017 me kontratë shitjeje nr. ***, për shumën 5, 500 euro.

Analizë Financiare

	<i>12.4.2012</i>
PASURI	1 608 965
Makinë “BMW” X5 3. ***	1 420 411
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>188 554</i>
Likuiditete gjendje	619 077
TË ARDHURA dokumentuar	881 938
Të ardhura nga paga e subjektit	374 561
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0
Nga shitja e makinës “Land Rover”	500 000
Interesa nga bankat	7 377
SHPENZIME	177 333
Shpenzime jetese	122 105
Shpenzime udhëtimi TIMS	12 016
Shlyer këste për kredinë 700,000 lekë	43 213
Mundësia për kursime	-904 360

25.1.1 Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit. Për këtë subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

25.1.2 Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortit të saj, të deklaruara në DPV/2012, të realizuara në vitin 2012, në shumën 1, 113, 683 lekë, për pasojë, konkluzioni nuk është i saktë.

25.1.3 Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimin e subjektit, të pashoqëruar me dokumentacion mbështetës, vlerëson se të ardhurat e pretenduara të fituara nga bashkëshorti i subjektit, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, për aq kohë sa nuk provohet pagimi i tatimeve

për to¹⁶. Në këto kushte, konkludohet se subjekti nuk arriti të provojë mundësitë financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

25.2 Me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2012, bashkëshorti i subjektit i ka shitur z. G.D., (nipi i E.D.) automjetin “Land Rover”, vlera 10, 000 euro. Ky automjet është blerë në datën 22.1.2008 me kontratën nr. *** për shumën 500, 000 lekë.

25.2.1 Nga hetimi¹⁷ ka rezultuar se:

- Automjeti është ende në emër të z. E.D.;
- Policat e sigurimit për këtë automjet janë në emër të bashkëshortit të subjektit, i cili rezulton pronar;
- Asnjë nga policat e sigurimit nuk është në emër të z. G.D., qoftë dhe si përdorues, detyrim ligjor i parashikuar nga legjislacionin rrugor në fuqi;
- Automjeti është shitur në një vlerë shumë më të lartë se çmimi i blerjes pas kalimit të 4 vjetëve përdorim.

25.2.2 Në kushtet e mësipërme ngrihen dyshime që shitja e automjetit është bërë në mënyrë fiktive. Për këtë arsye i është kërkuar subjektit të provojë burimin e ligjshëm të ardhurave të z. G.D., për blerjen e këtij automjeti. Nga ana e saj nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave të z. G.D.

25.2.3 Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës: (i) duke u ngritur dyshime për shitje fiktive të këtij automjeti, me qëllim justifikimin e të ardhurave; (ii) subjekti nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti mbi çmimin e blerjes, si rrjedhojë, diferenca e shumës çmim shitje/çmim blerje e automjetit nuk do të përfshihet në analizë financiare (sipas nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës).

25.2.4 Në parashtrimet e tij, subjekti nuk ka paraqitur asnjë prove për të provuar të kundërtën e këtij rezultati. Ajo është mjaftuar duke shpjeguar se shitja e automjetit është bërë me kontratë dhe këtë kontratë e ka depozituar. Në lidhje me pagesën e tatimit për diferencën e çmim shitje/çmim blerje, subjekti ka pretenduar se ky fakt nuk i është bërë i ditur nga noteri.

25.2.5 Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, konkludon se subjekti nuk ka provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, madje as nuk është përpjekur për këtë, duke e vënë subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të rremë në lidhje me automjetin tip “Land Rover”, në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a”, “b”, “ç” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

26. Figuroj **bashkëpronare** me A.H., M.H., dhe L.K., mbi një **apartament me sipërfaqe 95.5 m²** ndodhur në Delvinë¹⁸, nga e cila do heq dorë me daljen e certifikatës së pronësisë, tani pas vdekjes së nënës sime M.H. Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Arsyetimi ligjor

26.1 Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Sarandë nr. ***prot., datë 26.10.2016, subjekti ka të regjistruar në bashkëpronësi me shtetasit A.H., M.H., dhe L.K., një apartament me sipërfaqe

¹⁶ Për më shumë shiko pikën 36.1 të këtij vendimi.

¹⁷ (i) Shkresë nr. ***, datë 4.12.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor; (ii) Shkresë nr. ***, datë 5.2.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.

¹⁸ Subjekti ka dorëzuar shkresë nga ZVRPP-ja Sarandë nr.*** prot., datë 26.10.2016

95.5 m², ndodhur në Delvinë, me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, lagjja “****”. Kjo pasuri është përfituar nga procesi i privatizimit dhe subjekti ka qenë bashkëpronare që në momentin e privatizimit. Kjo pasuri nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në asnjë nga deklaratat periodike. Ky mosdeklarim nuk përbën shkak për shkarkimin e saj për sa kohë kjo pasuri rrjedh nga privatizimi, subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e saj dhe është e regjistruar në ZVRPP. Për më tepër, subjekti në datën 27.7.2017 me kontratë dhurimi nr. *** i ka dhuruar vëllait të saj A.H., pjesën takuese në këtë apartament.

26.2 Pas hetimit, nuk kanë rezultuar probleme për këtë pasuri.

27. Llogari bankare¹⁹ me nr. ***, datë 19.2.2008 në emrin tim dhe të nënës sime M.H., (sot e vdekur) me vlerë 404, 998,72 lekë. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Kjo shumë është totalisht e nënës sime, por emri im është vënë për efekt të tërheqjes në pamundësi të ardhjes së saj për shkak të sëmundjes që kishte.

Arsyetimi ligjor

27.1 Bazuar në shkresën e “Tirana Bank”²⁰ rezulton se subjekti ka llogari dyemërore me nënën e saj. Llogaria është hapur më 19.2.2008 dhe veprimet në të janë kryer nga ana e nënës së saj. Teprica e llogarisë në datën 27.1.2017 rezulton të jetë 404, 998,72 lekë.

27.2 Nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

28. Llogari rrjedhëse²¹ me nr. ***, datë 7.4.2011 në emër të vajzës sime O.D., me vlerë 1,109,184,79 lekë, e cila është hapur duke iu hedhur nga 10.000 lekë nga paga ime që nga viti 2009 dhe përveç kësaj shume që i hidhet çdo muaj, pasi iu mbyll llogaria e kursimit në “Procredit Bank”, për shumën 373, 314,87 lekë (mbledhur nga urimet për lindjen e saj) (shiko faturën me nr. ***, datë 9.1.2014 “Procredit Bank”) janë hedhur në nr. llogarie *** shuma prej 370.000 lekë, sipas dokumentit bankar datë 14.1.2014 (shiko vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2017 të “Raiffeisen Bank”).

29. Llogari rrjedhëse te “Raiffeisen Bank”, dega Sarandë, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 20.1.2017, me vlerë 8, 453,21 lekë; 34,77 lekë dhe 31,40 euro.

Konstatimi i ILDKPI-së:

➤ *Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2014, hapjen e llogarisë në emër të vajzës në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 370.000 lekë.*

¹⁹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vërtetim bankar nga “Tirana Bank” nr. *** prot., datë 25.1.2017; (ii) nxjerrje llogarie nga Tirana Bank.

²⁰ Kthim përgjigjeje nga “Tirana Bank”, nr. *** prot., datë 13.12.2019

²¹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- i. Vërtetim nga “Raiffeisen Bank” nr.*** prot., datë 20.1.2017, sipas të cilit O.D., ka llogari rrjedhëse me nr. ***, hapur më 7.4.2011, gjendja e llogarisë në datën 20.1.2017 është 1, 109, 184 lekë.
- ii. Mandat nga “ProCredit Bank”, datë 9.1.2014, ku Nevrie Duka mbyll llogarinë e kursimit, duke tërhequr shumën prej 373.314 lekë.
- iii. Depozitim në “Raiffeisen Bank” datë 14.1.2014, ku Nevrie Duka derdh shumën prej 370,000 lekë për O.D.
- iv. Vërtetim nga “Raiffeisen Bank” nr. *** prot, dt. 20.1.2017, sipas të cilit Nevrie Duka ka:
 - a. Llogari rrjedhëse nr. ***, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 8.453 lekë.
 - b. Llogari nr. ***, me gjendje 34,77 lekë.
 - c. Llogari nr. ***, me gjendje 31,4 euro.

Arsyetimi ligjor

28.1 Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank”²² rezulton se vajza e subjektit ka llogari në lekë, në shumën 3, 240, 065 lekë. Në këtë llogari, në datën 14.1.2014 është depozituar shuma 370,000 lekë, e cila e ka burimin nga tërheqja e kryer në datën 9.1.2014 në “Procredit Bank”.

29.1 Subjekti ka llogari rrjedhëse me gjendje 103,323 lekë.

29.2 Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

30. Gjendje Cash në shumën prej 1.3 (një presje tre) milion lekë si kursime nga 500 (pesëqind mijë) lekëve të vitit të shkuar 2015, plus 800 (tetëqind mijë) lekë kursime gjatë vitit 2016. Burim: nga të ardhurat e bashkëshortit plus paga e saj.

30.1 Në tabelë paraqitet analiza financiare për këto dy vite:

	2015	2016
PASURI	355 602	913 258
Dhënë hua vëllait të bashkëshortit 15,000 euro	2 064 750	
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>-1 709 148</i>	<i>913 258</i>
Likuiditete gjendje	1 507 701	2 420 959
TË ARDHURA dokumentuar	1 705 478	1 493 245
Të ardhura nga paga e subjektit	1 537 596	1 480 102
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0	0
Interesa nga bankat	17 882	13 143
Kredi në RZB/Neptun 150,000 lekë	150 000	
SHPENZIME	1 397 741	1 145 525
Shpenzime jetese	672 828	705 276
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	11 882	71 159
Shlyer këstet për kreditë e marra	279 081	94 483
Blerje mallrash	154 900	
Shpenzime kredie	3 000	
Shpenzime mobilimi ²³	275 300	270 540
Shpenzime të tjera (Hipotekë/Dëshmi trashëgimie)	750	4 067
Mundësia për kursime	-47 865	-565 537

30.2 Nga analiza financiare rezulton se për të dyja vitet, subjekti nuk ka patur mundësi që të kursejë respektivisht shumën 500,000 lekë dhe 800,000 lekë.

²² Kthim përgjigjeje “Raiffesien Bank”, nr.*** prot., datë 10.12.2019

²³Shih pyetësin nr.3, ku përcaktohet shuma totale 5,000 euro, por pa specifikuar shumat për çdo vit. Për pasojë shpenzimet e mobilimit janë ndarë për periudhën shtator 2014 - 2016 në masën 20% - 40% - 40%.

30.3 Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar mundësitë financiare për krijimin e gjendjes *cash*.

30.4 Në parashtrimet e tij, subjekti ka shpjeguar se referuar DVP/2014, kursimet *cash* për këtë vit janë deklaruar në masën 2, 400, 000 lekë. Të ardhurat e bashkëshortit janë 1, 500, 000 lekë, ndërsa të subjektit 1, 537, 596 lekë. Shuma në total është 5, 437, 596 lekë. Kjo është shuma që çelet viti 2015, sipas subjektit. Përveç kësaj, subjekti shton se i ka dhënë hua G.D., shumën 15, 000 euro x 125 lekë = 1, 875, 000 lekë. Shuma mbetje është 3, 562, 596 lekë. Ndërkohë që në vitin 2015 të ardhura nga bashkëshorti janë 1, 400, 000 lekë dhe të subjektit 1, 537, 596 lekë. Subjekti arsyeton kështu se nga llogaria e bërë nuk rezulton mungesë e mjeteve monetare.

30.5 Pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, të pashoqëruara me prova, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues në lidhje me krijimin e kursimeve *cash* në shumën 2, 400, 000 lekë në vitin 2014. Në asnjë prej deklaratave periodike deri në vitin 2014 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar kursime *cash*. Nga analiza financiare rezulton se ajo nuk ka patur mundësi për të krijuar kursime *cash* në vitin 2014 në shumën 2, 400, 000 lekë, pasi ajo rezulton me një bilanc negativ në shumën 1, 679, 532 në këtë vit.

30.6 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, ka rezultuar se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion të ardhurat e bashkëshortit, as mënyrën e përfitimit të tyre dhe as tatimin e paguar për to, duke mos i vërtetuar si të ardhura të ligjshme.

30.7 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme gjendjen *cash* në shumën 1, 300, 000 lekë, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

31. Në vitin 2006 i kam dhënë një shoqes sime, K.D., shumën prej 5.000 USD hua. Nuk m’i ka kthyer akoma. Janë dhënë në mirëbesim, pa dokument.

Konstatimi i ILDKPI-së:

➤ *Subjekti nuk ka deklaruar huan e dhënë në vlerën 5.000 USD shtetases K.D., në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2006.*

31.1 Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka patur mundësi të japë huan në vlerën 5,000 USD. Kjo hua nuk rezulton e deklaruar në DVP/2006. Subjektit iu kalua barra e provës për këtë rezultat të hetimit.

31.2 Në parashtrimet e paraqitura pas kalimit të barrës së provës, subjekti e konsideruar një harresë të paqëllimshme mosdeklarimin e kësaj huaje në DVP/2006, ndërsa në lidhje me mundësitë financiare, subjekti i ka shpjeguar me të ardhurat e bashkëshortit në vitin 2005 janë në shumën 2, 000, 000 lekë.

31.3 Komisioni pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, të pashoqëruara me prova, konkludon se ndodhemi përsëri në të njëjtat kushte, ku të ardhurat e bashkëshortit nuk provohen se janë përfituar, si dhe nuk provohet as të jenë paguar tatime për këto të ardhura. Duke qenë se këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni D/3 i Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të merren në konsideratë. Për pasojë, subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme dhënien e kësaj huaje, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit

D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61 pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

DETYRIME FINANCIARE

32. Janë marrë 2 kredi²⁴ në shumat 700,000 lekë dhe 400,000 lekë përkatësisht në datën 19.4.2010 dhe 28.5.2014 në emrin Nevrie dhe E.D., por për llogari të kunatit tim A.D., (shih deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2015). Këto kredi janë shlyer dhe mbyllur nga A., dhe A.D.

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Subjekti nuk ka deklaruar kredinë prej 700,000 lekë në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2010 dhe kredinë prej 400,000 lekë në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2014 si dhe shlyerjet e tyre në deklaratat në vazhdim.*
- *Subjekti nuk ka deklaruar detyrimet e vëllait të bashkëshortit për shlyerjet e kredive nga ana e saj, si dhe likuidimin e këtyre detyrimeve në deklaratat e interesave private ndër vite.*

Arsyetimi ligjor

32.1 Në lidhje me kreditë e marra në “Raiffeisen Bank”, rezulton se z. A.D., dhe znj. A.D., me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2015, deklarojnë se: *“Në vitin 2010 kanë pasur nevojë për mobilimin e shtëpisë dhe meqënëse nuk i kanë plotësuar kushte për të marrë kredi, i kanë kërkuar ndihmë të vëllait, E.D., i cili së bashku me bashkëshorten kanë marrë një kredi në datë 19.4.2010 në shumën 700,000 lekë pranë “Raiffeisen Bank”. Po kështu është marrë një kredi edhe në datë 28.5.2014 në shumën 400,000 lekë. Ky detyrim i është likuiduar sipas mundësive (duke i dhënë një kësht të parë para datës 28.5.2014) ndërsa diferenca do të jepet kur të krijohet mundësia për të cilën është rënë dakord.”*

32.2 Nga hetimi administrativ²⁵ ka rezultuar se subjekti së bashku me bashkëshortin e saj kanë marrë dy kredi pranë “Raiffeisen Bank”, të cilat i kanë likuiduar me të ardhurat e tyre. Nga ana e subjektit nuk rezulton të jenë deklaruar këto dy kredi si dhe shlyerja e tyre në deklaratat periodike vjetore. Nëse bazohemi në deklaratën noteriale rezulton se këto kredi janë shlyer me të ardhurat e subjektit, ndërsa vëllai i bashkëshortit të saj i ka paguar vetëm një kësht. Nga ana e subjektit nuk është sqaruar se kur janë paguar vlera e mbetur e kredive nga vëllai i bashkëshortit, si dhe nuk është vënë në dispozicion burimi i ligjshëm i të ardhurave të vëllait të bashkëshortit për shlyerjen e këtyre kredive.

32.3 Kreditë janë lëvruar:

32.3.1 Në datë 19.4.2010 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë marrë kredi bankare pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 700,000 lekë me afat 84 muaj. Nga nxjerrja e llogarisë bankare të subjektit ka rezultuar se kjo kredi është përdorur si më poshtë:

- (i) Shuma 400,000 lekë i është transferuar znj. V.H.C., në datën 24.4.2010.

²⁴ Subjekti ka dorëzuar deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2015

²⁵ Kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” nr. *** prot., datë 10.12.2019

Në lidhje me këtë transferimin subjekti ka sqaruar se znj. C., është shoqja e kumatës së saj, e cila këtë shumë ia kishte dhënë kumatës përpara se të disbursohej kredia. Me disbursimin e kredisë ajo ia ka kaluar znj. C., shumën 400, 000 lekë. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar këtë deklaram të saj.

- (ii) Shuma 238,672 lekë është përdorur për gjendjen negative që ka qenë në llogari të subjektit.

Në lidhje me përdorimin e kësaj shume nga ana e saj subjekti ka sqaruar se interesi i overdraftit ishte më i lartë se i kredisë, kështu që me kredinë do të paguanin më pak interesa.

32.3.2 Në datën 28.05.2014 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë marrë kredi bankare pranë “Raiffeisen Bank” në shumën 400, 000 lekë me afat 12 muaj. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se kredia është disbursuar në datën 29.5.2014 në shumën 400, 000 lekë. Kjo shumë është tërhequr *cash* nga subjekti në datë 3.6.2014. Subjekti nuk provon që këtë shumë ia ka dhënë vëllait të bashkëshortit të saj.

32.4 Duke qenë se subjekti ka pretenduar se kreditë e mësipërme janë shlyer me të ardhurat e vëllait të bashkëshortit, i është kërkuar asaj të depozitohë dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. A.D. Nga ana e saj nuk është depozituar dokumentacion provues.

32.5 Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për këto rezultate: (i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike marrjen e këtyre kredive; (ii) subjekti nuk provon me dokumentacion provues që këto dy kredi i janë dhënë vëllait të bashkëshortit, por provohet që shumat 700, 000 lekë dhe 400, 000 lekë janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) ndryshe nga sa është deklaruar në deklaratën “Vetting”, provohet që kredia në shumën 700, 000 lekë nuk është përdorur nga vëllai i bashkëshortit të subjektit; (iv) subjekti nuk provon me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. A.D., për shlyerjen e këtyre kredive.

32.6 Në parashtrimet e paraqitura për kundërshtimin e barrës së provës, subjekti ka pretenduar se: *“Kjo kredi nuk më përkiste mua, por vëllait të burrit dhe bashkëshortes së tij. Duke qenë se në DVP mungon rubrika përkatëse që flet në lidhje me të tretët, unë nuk e kam deklaruar për të qenë korrekt me rubrikat.”* Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni vlerëson se për sa kohë kjo kredi ishte marrë nga subjekti, ajo kishte detyrimin ligjor për ta deklaruar atë dhe për të dhënë shpjegime në lidhje me përdorimin e saj.

32.7 Në lidhje me mundësitë financiare të kumatit dhe bashkëshortes së tij, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument, por është mjaftuar me arsyetimin se personat janë të punësuar dhe e kanë likuiduar kredinë me të ardhurat e tyre.

32.8 Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultatit të hetimit, për pasojë subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

32.9 Nga nxjerrja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se subjekti ka depozituar shumën 935, 700 lekë në datën 24.8.2005. Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të kryer këtë depozitë. Gjithashtu ky depozitim nuk është deklaruar në DVP/2005.

32.10 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegon se për vitin 2005 të ardhurat e saj kanë qenë, sipas DVP-së, në masën 3, 342, 950 lekë, duke i konsideruar të mjaftueshme për depozitimin e shumës 935, 700 lekë.

32.11 Komisioni konstaton se subjekti nuk ka sqaruar përse ky depozitim nuk është deklaruar në DVP/2005 dhe për më tepër nuk ka depozituar asnjë dokument apo provë për të vërtetuar të ardhurat në shumën e pretenduar. Në këto kushte, Komisioni i vlerëson shpjegimet e subjektit jo bindëse. Për pasojë, subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme depozitimin e shumës 935, 700 lekë në datën 24.8.2005.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT – EDMOND DUKA DEKLARIMI I PASURIVE

33. Tokë truall²⁶ me sipërfaqe 360 m², në emër të E.D., marrë me vendimin nr. ***, datë 5.6.2003 të Këshillit Bashkiak, Sarandë (e pahipotekuar). Nuk është deklaruar burim në deklaratën “Vetting”.

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Konstatohet se trualli i jepet bashkëshortit të subjektit nga Bashkia Sarandë, si investitor i sheshit të ndërtimit (numri dhe funksioni i kateve mbi tokë 2-3 kate), bëhet piketimi i objektit, por nuk është deklaruar dhe është e panjohur gjendja aktuale e punimeve apo ecuria e tyre ndër vite.*

Arsyetimi ligjor

33.1 Nga hetimi²⁷ ka rezultuar se me vendim të Këshillit Bashkiak, Sarandë nr. ***, datë 5.6.2003, bashkëshortit të subjektit i është dhënë si investitor i sheshit të ndërtimit, blloku nr. ***, parcela ***, me sipërfaqe 360 m², me këto kondicione urbanistike - arkitektonike: vija e ndërtimit 3 m², koeficienti i shfrytëzimit të territorit 0.4 m², numri dhe funksioni i kateve mbi tokë 2-3 kate, lloji i mbulesës soletë + çati, lartësia e katit tip 3m. Në datë 18.6.2003 është bërë dhe piketimi i objektit, bazuar në procesverbalin e piketimit të datës 18.6.2003.

Në datë 16.7.2019, me kontratë shitblerjeje nr. ***, bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë truall nga Bashkia Sarandë. Kontrata është lidhur në zbatim të vendimit nr. *** datë 7.5.2019 të Gjykatës Administrative Gjirokastër.

Në lidhje me këtë truall subjekti ka sqaruar se nuk është kryer asnjë punim përveç gërmimit me mjetin e tyre gërmues.

33.2 Bazuar në shkresën nr. ***, datë 24.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, rezulton se subjekti ka dhënë vendim datë 6.5.2019 me palë Bashkia Sarandë, ndërkohë që bashkëshorti i saj ishte në një proces gjyqësor me Bashkinë në lidhje me tokën truall. Në këto kushte, subjekti, bazuar në nenin 72 të K.Pr.Civile, nuk duhej të gjykonte këtë çështje, pasi

²⁶Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vendim i Këshillit Bashkiak, Sarandë nr. ***, datë 5.6.2003; (ii) planimetria e sheshit të ndërtimit, miratuar nga KRRT-ja, Bashkia Sarandë; (iii) Procesverbal piketimi datë 18.6.2003, mbajtur nga zyra e urbanistikës, Sarandë.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

ishite në kushtet e konfliktit të interesit me Bashkinë Sarandë, për sa kohë bashkëshorti i saj ishte në një proces gjyqësor me këtë Bashki.

33.3 Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këto rezultate: (i) rezulton e paqartë se si trualli i jepet bashkëshortit të subjektit nga Bashkia Sarandë, si investitor i sheshit të ndërtimit (numri dhe funksioni i kateve mbi tokë 2 - 3 kate), bëhet piktimi i objektit, por nuk është deklaruar dhe është e panjohur gjendja aktuale e punimeve apo ecuria e tyre ndër vite. (ii) Duket se subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit.

33.4 Subjekti nuk dha asnjë shpjegim dhe nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me gjendjen aktuale të truallit. Ndërsa në lidhje me dyshimin e ngritur për konflikt interesi në gjykimin me palë Bashkinë Sarandë, ajo shpjegon: *“Unë kam qenë në konflikt me Bashkinë Sarandë vetëm për problemin tim, që ka qenë lidhja e kontratës për këtë truall. Këtë çështje nuk e kam shqyrtuar unë si gjyqtare, por Gjykata Administrative. Për të gjitha problematikat e tjera që lidhen me Bashkinë Sarandë unë nuk jam në konflikt.”* Sipas gjyqtares - subjekt rivlerësimi, është problemi që të bën me konflikt dhe jo thjesht institucioni.

33.5 Në konkluzion të shpjegimeve të paraqitura, Komisioni konstaton se:

(i) subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar gjendjen aktuale të truallit të përfutur nga bashkëshorti i saj, (ii) subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit.

Për sa më sipër vlerësohet se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germa “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe është në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të nenit 33/5, germa “d”.

34. Tokë truall, me sipërfaqe 200 m² ²⁸, në emër të E.D., marrë me vendimin nr. ***, datë 18.11.1991 të Këshillit Bashkiak, Sarandë (e pahipotekuar), blerë me kontratë shitjeje datë 22.1.1992, në vlerën 12, 000 lekë.

Konstatimi i ILDKPI-së:

➤ *Konstatohet se trualli është përfutur nga Bashkia Sarandë, për ndërtim banesë vetjake, por nuk është deklaruar dhe është e panjohur gjendja aktuale e punimeve apo ecuria e tyre ndër vite.*

Arsyetimi ligjor

34.1 Me vendim të Këshillit Popullor, Sarandë, nr. ***, datë 18.11.1991 është vendosur dhënia e parcelës për ndërtim banesë vetjake nr. 35 - 36 bashkëshortit të subjektit në bllokun e banimit, sipas studimit urbanistik të miratuar me vendim të Komitetit Ekzekutiv KP të rrethit, në lagjen “***”. Në datën 22.1.1992 bashkëshorti i subjektit ka blerë truallin me sipërfaqe 200 m², për shtëpi banimi, vlera 12, 000 lekë.

34.2 Bazuar në kartelën e pasurisë të këtij trualli, tek shënimet transkriptimi është bërë përshkrimi: *në bazë të deklaratës noteriale për heqje dorë pasurie nr. ***, datë 12.9.2001, kjo pasuri fshihet dhe kalon në favor të V.D.*

²⁸ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vendim i Këshillit Popullor, Sarandë nr.***, datë 18.11.1991; (ii) kontratë shitjeje datë 22.1.1992.

34.3 Është pyetur subjekti në lidhje me këtë truall. Nga ana e saj është deklaruar se ajo nuk ka asnjë informacion se çfarë është bërë me truallin, pasi bashkëshorti i saj ka hequr dorë që në vitin 2001.

34.4 Në përfundim, ka rezultuar e paqartë arsyeja e deklarimit në deklaratën “Vetting” të një pasurie që nuk është në pronësi të bashkëshortit.

34.5 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka sqaruar se kjo pronë ka qenë në pronësi të bashkëshortit të saj gjatë regjimit të parë martesor, prej së cilës ka hequr dorë, duke ia lënë ish-bashkëshortes. Në lidhje me arsyen e deklarimit, subjekti ka sqaruar se nuk e ka ditur këtë fakt.

34.6 Pavarësisht deklarimeve të subjektit mbetet fakt se ajo ka deklaruar një pasuri që nuk është në pronësi të saj, duke e vënë atë në kushtet e deklarimit të pasaktë.

35. Subjekti²⁹ ka deklaruar në emër të bashkëshortit këto mjete:

- i. Autoveturë, tip “Mercedes - Benz”, blerë nga E.D., me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.4.2004 dhe e shitur me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.1.2008.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Nuk deklarohet.

- ii. Kamion “Man”, *** , blerë nga E.D., me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2005.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Nuk deklarohet.

- iii. Skrep me gjithë çekiçin pneumatik-hidraulik, blerë nga E.D., me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.4.2007, blerë 15, 000 euro.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Nuk deklarohet.

- iv. Autoveturë e markës “Land Rover”³⁰, blerë në datën 13.5.2009 dhe shitur me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2012.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Nuk deklarohet.

- v. Autoveturë “BMW”³¹ X5 3.0D, viti 2006, në emër të E.D., Nevrie Duka sipas certifikatës së mjetit nr. *** , datë 23.4.2012, blerë 12, 000 euro.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Nuk deklarohet.

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Subjekti nuk ka deklaruar në deklarimin e interesave private periodike vjetore 2008, shitjen e automjetit “Benz” 300, me targa *** dhe vlerë 500,000 lekë;*
- *Automjeti është blerë në vitin 2004 në vlerën 250,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 ose 4 vite më pas me vlerë 500,000 lekë.*
- *Subjekti nuk ka deklaruar vlerën e kamionit prej 1,500, 000 lekë në deklarimin “Vetting”.*
- *Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës 15,000 euro, që ka shërbyer për blerjen e makinerisë “skrep me çekiç” në vitin 2007.*

²⁹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë nr.*** rep., nr. *** kol., datë 2.4.2004; (ii) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 22.1.2008; (iii) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2005; (iv) kontratë shitjeje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 3.4.2007, (v) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2012.

³⁰ Trajtuar me lart

³¹ Trajtuar me lart

- *Deklarim i pasaktë në lidhje me vitin e blerjes së makinerisë “skrep me çekiç” në deklaratat ndër vite, pasi është deklaruar blerja e makinerisë në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2006, ndërsa kontrata e blerjes i përket vitit 2007.*

Arsyetimi ligjor

35.1 Me kontratën nr. ***, datë 2.4.2004 bashkëshorti i subjektit ka blerë automjetin “Mercedes - Benz”, ***, me vlerë 250, 000 lekë. Ky automjet është shitur në datë 22.1.2008 me kontratë nr. ***, për shumën 500,000 lekë. Nga ana e DPSHTRR-së rezulton që ky automjet ka qenë në pronësi të z. E.D., edhe pas shitjes së tij, vërtetuar me vërtetim nr. *** të Drejtorisë Rajonale Sarandë, ku deklarohet se automjeti me targa *** është hequr nga qarkullimi në datën 6.11.2017, sipas kërkesës së aplikantit E.D. Bashkëlidhur është dhe formulari i vetëdeklarimit datë 6.11.2017 i z. E.D., për çregjistrimin e këtij mjeti.

35.1.1 Në kushtet kur: (i) automjeti ka qenë i regjistruar në emër të z. E.D., (ii) automjeti është shitur në një vlerë më të lartë se çmimi i blerjes pas kalimit të 4 vjetëve përdorim, (iii) bashkëshorti i subjektit ka kryer veprimet pranë DPSHTRR-së për çregjistrimin e këtij automjeti dhe pas shitjes së tij, Komisioni ngriti dyshime për shitje fiktive të këtij mjeti, me qëllim justifikimin e të ardhurave. Për këtë iu kalua barra e provës subjektit.

35.1.2 Gjithashtu subjektit iu kaluar barra e provës dhe për mospagimin e detyrimeve tatimore për shitjen e këtij automjeti, si rrjedhojë në analizën financiare nuk është përfshirë diferenca çmim shitje/çmim blerje.

35.1.3 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se detyrimi për çregjistrim i përkiste blerësit dhe jo bashkëshortit të saj. Kur është vënë në dijeni se mjeti ishte jashtë përdorimit dhe ende në emër të bashkëshortit kanë kryer çregjistrimin.

35.1.4 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, për më tepër blerësi i këtij automjeti rezulton të jetë z. A.D., i cili është vëllai i bashkëshortit të saj. Kështu konkludohet se kemi të bëjmë me një kontratë fiktive shitjeje, duke e vënë subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të rremë në lidhje me automjetin, tip “Mercedes - Benz” në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gerrat “a”, “b”, “ç” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

35.2 Me kontratë shitje nr. *** kol., datë 29.1.2005, bashkëshorti i subjektit ka blerë kamion “Man”, për shumën 1, 500, 000 lekë. Burimi i këtij kamioni është kredia e marrë në vitin 2005 me kontratë huaje nr. ***, datë 28.1.2005, në shumën 1,500,000 lekë dhe e deklaruar nga subjekti në DVP/2005.

35.2.1 Ka rezultuar nga hetimi se në deklaratën “Vetting” subjekti nuk e ka deklaruar këtë kredi. Ky mosdeklarim i subjektit përbën pasaktësi, por që nuk përbën shkak për shkarkim, për sa kohë ajo është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike, duke mos e vënë subjektin në kushtet e fshehjes.

35.3 Me kontratë shitjeje nr. *** kol., datë 3.4.2007, bashkëshorti i subjekti ka blerë skrep me çekiç pneumatik dhe frigorifer për çmimin 15, 000 euro. Bazuar në kontratën e shitjes kësti i parë prej 14, 000 euro është likuiduar më datë 10.6.2006 dhe kësti i dytë 1, 000 euro paguhet me nënshkrimin e kontratës.

35.3.1 Në DVP/2006 si burim për blerjen e këtij mjeti subjekti deklaron mbyllje depozite dhe tërheqje në shumën 13, 000 USD në “Raiffeisen Bank”. Nga analiza financiare³² rezultojnë:

	10.6.2006
PASURI	1 562 612
Skrep + çekici automatik nga D.H.	1 731 842 ³³
<i>Shtesa/Pakësime likuiditeteve</i>	<i>-169 230</i>
Likuiditete gjendje	171 520
TË ARDHURA dokumentuar	333 712
Të ardhura nga paga e subjektit	323 145
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0
Interesa nga bankat	10 567
SHPENZIME	470 323
Shpenzime jetese	97 323
Shpenzime udhëtimi TIMS	0
Shlyer këste kredie	373 000
Mundësia për kursime	-1 699 224

35.3.2 Në lidhje me burimin e deklaruar për blerjen e mjetit “skrep”, nuk është evidentuar asnjë hapje depozite në dollarë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2004³⁴, si dhe asnjë tërheqje apo mbyllje të kësaj depozite në vitin 2006. Kjo depozitë nuk është përfshirë në analizën financiare të vitit 2004, pasi nuk është provuar ekzistenca e saj. Për rrjedhojë, nuk konsiderohet si burim për blerjen e skrepit nga bashkëshorti, sikurse deklaruar në DVP/2006.

35.3.3 Në përfundim të hetimit për këtë mjet ka rezultuar se: (i) nga analiza financiare rezultojnë se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të blerë mjetin tip “skrep”; (ii) duket sikur subjekti ka kryer deklarim të rremë në lidhje me burimin e kësaj pasurie. Subjektit iu kalua barra e provës për këtë rezultat të hetimit.

35.3.4 Sipas shpjegimeve të subjektit, të ardhurat familjare të saj për vitin 2005 janë në shumën 3, 342, 950 lekë³⁵. Ka dhënë hua 5000 USD ose 535, 000 lekë dhe teprica për vitin 2005 është 2, 707, 950 lekë. Ndërsa për vitin 2006, subjekti llogarit të ardhurat e saj 958, 000 lekë + të ardhurat e bashkëshortit 1, 500, 000 lekë + tepricat e vitit 2005 = 5, 166, 154 lekë total. Nga këto kanë shpenzuar 15, 000 euro (konvertuar 1, 950, 000 lekë), duke rezultuar si balancë në fund të vitit 2006 me shumë 3, 216, 154 lekë.

35.3.5 Pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit konstatohet se: (i) subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar që ajo ka patur depozitë në shumën 13, 000 USD në “Raiffeisen Bank”, për rrjedhojë, kjo depozitë nuk është përfshirë në analizë financiare; (ii) subjekti nuk

³² Në analizën financiare nuk është përfshirë kthimi i huas 30,000 USD në shkurt 2006, pasi nuk është provuar burimi i ligjshëm të ardhurave të z. A.D., për kthimin e kësaj shume, por dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave të subjektit për dhënien e kësaj huaje.

³³ Kursi këmbimit 1 Eur = 123.7 Lek, datë 31.12.2006, Banka e Shqipërisë.

³⁴ DVP/2004 subjekti deklaron “depozitë bankare në emrin tim dhe bashkëshortit në shumën 13,004 USD”.

³⁵ Shuma e dëguar nga motra që jeton në Angli prej 420, 000 lekë + të ardhura të subjektit 922,950 lekë + të ardhura të bashkëshortit 2, 000, 000 lekë.

ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e bashkëshortit të saj, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizë financiare; (iii) subjekti nuk rezultoi të ketë deklaruar gjendje *cash* në DVP/2003 - 2006; (iv) subjekti në vitin 2005 i ka dhënë hua z. A.D., shumën 30, 000 USD.

35.3.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshëm blerjen e mjetit tip “skrep”, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a”, “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

36. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të deklaruar në deklaratën “Vetting” në shumën 22, 750, 000 lekë.

Konstatimi i ILDKPI-së:

- *Nuk është e qartë mënyra e marrjes së pagesave të bashkëshortit nga puna, për periudhën 2005 - 2014, nëse është bërë nëpërmjet sistemit bankar apo pagesë cash.*
- *Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me pagesën e detyrimeve ndaj shtetit për të ardhurat e bashkëshortit në vitet 2008 - 2014.*
- *Është e paqartë kryerja e punimeve të gërmimit nga bashkëshorti, pasi QKB-ja dhe organet tatimore nuk konfirmojnë aktivitetet të licensuar për kryerjen e tyre.*

Arsyetimi ligjor

36.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se të ardhurat e bashkëshortit të saj për periudhën 2005 - dhjetor 2016 janë në shumën **22, 750, 000 lekë**. Komisioni ka hetuar³⁶ gjerësisht në lidhje me këto të ardhura, si dhe tatimet e paguara.

36.1.1 Subjekti për të vërtetuar deklaramin e saj ka depozituar:

- Aktmarrëveshje nr. ***, datë 1.2.2005, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me objekt: *kryerja e punimeve nga E.D., me mjetin e vet kamion vetëshkarkues për nevoja të shoqërisë “****” sh.p.k. në objektet “Ndërtim i rrugës së varrezave Sarandë”, “Ndërtim i rrugës Turizëm - Kanali i ****” si dhe në objekte të tjera që ka me sipërmarrje kjo shoqëri*”.

Në bazë të aktmarrëveshjes shoqëria “****” sh.p.k. do të bëjë pagesat sipas volumit të punës së kryer dhe tarifave, të cilat do të miratohen nga të dyja palët. Marrëveshja përfundon në datë 1.2.2008. Pagesat do të bëhen çdo muaj sipas volumeve të punës të pasqyruara në situacionet e punimeve. Detyrimet e nënkontraktorit ndaj shtetit dhe të tretëve merren përsipër nga shoqëria.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.4.2008, sipas së cilës shoqëria “****” sh.p.k. ka kryer pagesat për E.D., në zbatim të marrëveshjes së datës 1.2.2005, si më poshtë:
 - a. Për vitin 2005, shuma 3, 000, 000 lekë;
 - b. Për vitin 2006, shuma 3, 500, 000 lekë;

³⁶Shkresë nr.*** prot., datë 29.1.2020 drejtuar “****” sh.p.k.
Kthim përgjigjeje “****”, nr.*** prot., datë 10.2.2020.
Shkresë, nr. *** prot., datë 29.1.2020, drejtuar “****” sh.p.k.
Kthim përgjigjeje “****” sh.p.k. nr.*** prot., datë 13.2.2020.
Shkresë, nr.*** prot., datë 5.2.2020, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Sarandë.
Kthim përgjigjeje, DRT-ja Sarandë nr. *** prot., datë 14.2.2020.

c. Për vitin 2007, shuma 2, 000, 000 lekë.

Në këtë deklaratë noteriale nuk përcaktohet se sa ka qenë volumi i punimeve i kryer nga ana e z. E.D., kur janë paguar këto shuma, si janë paguar këto shuma, si dhe nëse për këto shuma janë paguar detyrimet tatimore.

- Aktmarrëveshje nr. *** kol, datë 25.3.2008, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me objekt: *“Kryerja e punimeve nga E.D., me mjetin e vet, kamion vetëshkarkues, por edhe punime gjurmimi për nevoja të shoqërisë “****” sh.p.k. në objektet që kjo shoqëri ka me sipërmarrje. Shoqëria merr përsipër të kryejë pagesat sipas volumit të punës së kryer dhe tarifave për të cilat palët do të bien dakord rast pas rasti. Detyrimet që mund t’i lindin nënkontraktorit E.D., ndaj shtetit dhe palëve të treta i merr përsipër shoqëria “****” sh.p.k për t’i shlyer.”*

Aktmarrëveshja lidhet pa afat të caktuar. Pagesat do të bëhen çdo muaj sipas volumeve të punës të pasqyruara në situacionet e punimeve.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.5.2015 me deklarues shoqëria “****” sh.p.k dhe E.D., ku deklarohet se me aktmarrëveshjen e datës 25.3.2008 është rënë dakord që E.D., të punonte për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k me mjetin e tij “skrep” dhe kamion vetëshkarkues, duke kryer punime gjurmimi dhe transporti. Për kryerjen e punimeve nga E.D., për periudhën 2008 - 2013 shoqëria ka bërë pagesën ndaj tij sipas volumit të punimeve dhe situacioneve të rëna dakord mes tyre. Konkretisht shoqëria ka likuiduar në favor të E.D., këto shuma parash:
 - a. Për vitin 2008 ka paguar 2.300.000 lekë;
 - b. Për vitin 2009 ka paguar 650.000 lekë;
 - c. Për vitin 2010 ka paguar 3.000.000 lekë;
 - d. Për vitin 2011 ka paguar 1.800.000 lekë;
 - e. Për vitin 2012 ka paguar 1.100.000 lekë;
 - f. Për vitin 2013 ka paguar 1.200.000 lekë .

Të gjitha detyrimet ndaj shtetit, palëve të treta që rrjedhin nga puna e kryer nga E.D., për periudhën e mësipërme i ka marrë përsipër për t’i shlyer vetë shoqëria “****” sh.p.k.

Në këtë deklaratë noteriale nuk përcaktohet se sa ka qenë volumi i punimeve i kryer nga ana e z. E.D., kur janë paguar këto shuma, si janë paguar këto shuma, nëse për këto shuma janë paguar detyrimet tatimore.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 1.10.2015 me deklarues shoqëria “****” sh.p.k. dhe E.D., ku deklarohet se me aktmarrëveshjen e datës 25.3.2008 është rënë dakord që E.D., të punonte për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. me mjetin e tij “skrep” dhe kamion vetëshkarkues, duke kryer punime gjurmimi dhe transporti. Për kryerjen e punimeve nga E.D., për vitin 2014, shoqëria ka likuiduar në favor të tij shumën prej 900.000 lekë. Të gjitha detyrimet ndaj shtetit, palëve të treta që rrjedhin nga puna e kryer nga E.D., për periudhën e mësipërme i ka marrë përsipër për t’i shlyer vetë shoqëria “****” sh.p.k.

Në këtë deklaratë noteriale nuk përcaktohet se sa ka qenë volumi i punimeve i kryer nga ana e z. E.D., kur janë paguar këto shuma, si janë paguar këto shuma, nëse për këto shuma janë paguar detyrimet tatimore.

- Aktmarrëveshje, datë 13.8.2014 lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit, objekti: *“Marrja në përdorim nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k të mjeteve të*

ndërtimit: një kamion vetëshkarkues dhe një çekiç (mjet gjurmimi) kundrejt pagesës 150.000 lekë/muaj. Shoqëria “****” sh.p.k merr përsipër edhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe të tretëve. Afati i marrjes në përdorim do të jetë 4 muaj, nga data 14.8.2014 -14.12.2014.”

- Aktmarrëveshje, datë 3.2.2015 midis palëve shoqërisë “****” sh.p.k dhe bashkëshortit të subjektit, objekti: “Marrja në përdorim nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k të mjeteve të ndërtimit: një kamion vetëshkarkues dhe një çekiç (mjet gjurmimi) kundrejt pagesës 150.000 lekë/muaj. Shoqëria “****” sh.p.k. merr përsipër edhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe të tretëve. Afati i marrjes në përdorim do të jetë 10 muaj, nga data 4.2.2015 - 3.12.2015.”
- Aktmarrëveshje, datë 1.3.2016 midis palëve shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bashkëshortit të subjektit, objekti: “Marrja në përdorim nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. të mjeteve të ndërtimit: një kamion vetëshkarkues dhe një çekiç (mjet gjurmimi) kundrejt pagesës 120, 000 lekë/muaj. Shoqëria “****” sh.p.k. merr përsipër edhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe të tretëve. Afati i marrjes në përdorim do të jetë 10 muaj, nga datë 1.3.2016 deri në datë 31.12.2016.”

36.1.2 Subjekti ka deklaruar këto të ardhura ndër vite të bashkëshortit të saj:

Viti	2004	2005	2006	2007
Deklarimi	0	2-300 000 lekë/muaj	Mesatarisht 2-300,000 lekë/muaj	2,000,000
Burimi		Nga kamioni i blerë me kredi	Nga gjurmimet në hapjen e shesheve të ndërtimit që kryen bashkëshorti me mjetin gjurmues dhe kamion vetëshkarkimi	Hapje sheshe ndërtimi me mjet gjurmues dhe kamion vetëshkarkimi

Viti	2008	2009	2010	2011	2012
Deklarimi	2,300,000	650 000	3,000,000	1,800,000	1,100,000
Burimi	Nga gjurmimet në hapjen e shesheve	Në punimet e gjurmimit	Me punimet e gjurmimit	Punimet e gjurmimit	Me punimet e gjurmimit

Viti	2013	2014	2015	2016	2017
Deklarimi	1,200,000	1,500,000	1,400,000	1,200,000	1,100,000
Burimi	Me punimet e gjurmimit	Me gjurmime hapje sheshe dhe transport	Punimet me gjurmime hapje sheshe dhe transport	Punimet e gjurmimit	Me punimet e gjurmimit

36.1.3 Nga krahasimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti me deklaratimet e saj, konstatohet se:

i. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezulton se për periudhën 2014 - 2016 bashkëshorti i subjektit i ka dhënë me qira mjetet e tij shoqërisë “****” sh.p.k., ndërkohë

subjekti në deklaratat periodike 2014-2016 deklaroi se burimi i të ardhurave të bashkëshortit janë nga punimet e gërmimit.

ii. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.4.2008, shoqëria “****” sh.p.k. ka kryer pagesat për E.D., në zbatim të marrëveshjes së datës 1.2.2005 përkatësisht në vitin 2005 në shumën 3, 000, 000 lekë dhe në vitin 2006 në shumën 3, 500, 000 lekë. Ndërkohë subjekti në DVP/2005-2006 ka deklaruar se të ardhurat e bashkëshortit të saj janë 2 - 300,000 lekë në muaj.

iii. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***³⁷, datë 23.3.2018 të shoqërisë “****” sh.p.k., rezultoi se ajo ka paguar bashkëshortin e saj në shumën 970, 000 lekë. Ndërkohë subjekti në DVP/2017 deklaroi shumën 1,100,000 lekë.

36.1.4 Komisioni i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë në lidhje me aktivitetin e kryer nga bashkëshorti i saj, deklarin e tij në organet tatimore si dhe pagimin e detyrimeve tatimore.

DRT-ja Sarandë ka informuar Komisionin për sa më poshtë:

- a. Kryerja e punimeve nga bashkëshorti i subjektit për gërmime dheu, hapja e shesheve të ndërtimit me mjetet e tij si dhe realizimi i të ardhurave nga këto punime **konsiderohet veprimtari tregtare** dhe për këto të ardhura i ka lindur detyrimi tatimor, kjo në referim të nenit 6 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore” dhe pikave 6.1, 6.2 të UMF-së nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- b. Referuar dispozitave ligjore, **z. E.D., kishte detyrim ligjor për t’u regjistruar** në organet tatimore për veprimtarinë ekonomike të cilën kryente, kjo në referim të nenit 40, pika 1, 2 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pika 40 e UMF-së, nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- c. Shoqëritë “****” dhe “****” kishin detyrim ligjor për të deklaruar:
 - marrëveshjet e nënshkruara me z. E.D., për pjesën që kanë lidhje me deklarin e detyrimet tatimore;
 - ose në rast se do të kishin marrëdhënie punësimi me z. E.D.
- d. Pagesat për detyrimet e lindura nga kontratat e qirave ose marrëveshjeve deklarohen tek rubrika e tatimit në burim për të cilën:
 - Subjekti “****” sh.p.k.** nga viti 2005 deri në mars 2009 **nuk ka kryer asnjë pagesë.** Në vitin 2015 e në vazhdim subjekti ka deklaruar tatimin në burim me vlerë zero.
 - **Subjekti “****” sh.p.k. nuk ka kryer pagesa** në zërin tatim në burim për periudhën 2005 - 2016. Subjektit i është shtuar përgjegjësia e tatimit në burim në vitin 2018.

36.1.5 Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “****” sh.p.k., duke i kërkuar dokumentacion teknik në lidhje me punimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit si: (i) lejet e ndërtimit; (ii) aktet teknike të kohës që vërtetojnë kryerjen e punimeve ku të dalë qartë volumi, vlera e tyre dhe objekti ku janë kryer, (iii) situacionet mujore të punimeve për periudhën 2005 - 2008; (iv) dokumentacion kontabël, (v) në lidhje me qiranë i ka kërkuar pagesën e detyrimeve tatimore dhe dokumentacion kontabël.

³⁷ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2020.

Nga shoqëria “****” sh.p.k. jemi informuar se nuk disponon dokumentacion në lidhje me punimet dhe pagesat e kryera, pasi ka kaluar kohë e gjatë³⁸. Nga ana e shoqërisë nuk janë vënë në dispozicion të Komisionit lejet e ndërtimit, situacionet mujore të punimit si dhe aktet teknike të kohës që vërtetojnë kryerjen e punimeve nga bashkëshorti i subjektit dokumentacion, i cili nuk i nënshtrohet legjislacionit të cituar nga kjo shoqëri. Gjithashtu, nga shkresa e DRT-së Sarandë provohet që kjo shoqëri nuk rezulton të ketë deklaruar marrëveshjen që ka patur me z. E.D., si dhe nuk janë paguar detyrimet tatimore.

36.1.6 Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “****” sh.p.k., duke i kërkuar të njëjtin dokumentacion si më sipër. Edhe kjo shoqëri ka kthyer të njëjtën përgjigje, bazuar në të njëjtat akte ligjore, si “****” sh.p.k. Nuk janë vënë në dispozicion të Komisionit lejet e ndërtimit, situacionet mujore të punimit si dhe aktet teknike të kohës, që vërtetojnë kryerjen e punimeve nga bashkëshorti i subjektit, dokumentacion ky që nuk i nënshtrohet legjislacionit të cituar nga kjo shoqëri. Gjithashtu, nga shkresa e DRT-së Sarandë provohet që shoqëria nuk rezulton të ketë deklaruar marrëveshjen që ka patur me z. E.D., si dhe nuk janë paguar detyrimet tatimore.

36.1.7 Sipas shkresës së administruar nëpërmjet DPT-së nr. *** prot., datë 8.8.2017 rezulton se për shtetasin E.D., janë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore për muajin korrik 2014. Kjo pagesë është përfshirë në analizën financiare si e ardhur e bashkëshortit të subjektit. Gjithashtu nga lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, është evidentuar kalim page për muajt mars -maj 2011. Edhe kjo shumë është përfshirë si e ardhur në analizën financiare.

36.1.8 Komisioni i ka kërkuar informacion³⁹ dhe dokumentacion provues subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit. Nga ana e saj nuk është vënë në dispozicion dokumentacion provues.

36.1.9 Komisioni i ka kërkuar informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nëse subjekti ka shqyrtuar çështje, ku si palë kanë qenë shoqëritë “****” sh.p.k., “****” sh.p.k, z. A.P., administrator i kësaj shoqërie. Në datë 24.2.2020 Gjykata ka vënë në dispozicion të Komisionit çështjet e gjykuara nga ana e subjektit, ku si palë kanë qenë shoqëritë e lartpërmendura. Subjekti ka gjykuar çështjet e mëposhtme:

Data e vendimit		Objekti	Vendosur
8.5.2006	“****” paditës	Pagim shume	Pranuar
22.7.2010	A.(A.)P., administrator i “****” sh.p.k paditës	Kundërshtim Urdhri	Pranuar
22.4.2014	“****” sh.p.k i paditur	Pagim Page	Rrëzuar

Siç rezulton, subjekti ka gjykuar tri çështje me palë, të cilat, para ose pas përfundimit të gjykimit, kanë lidhur marrëveshje me bashkëshortin e saj për kryerjen e punimeve të

³⁸ Shoqëria i është referuar:

- a. Neni 17 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku parashikohet afati 10 vjet për ruajtjen e regjistrit kontabël.
- b. Neni 116/1 të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. **Ky ligj nuk gjen aplikim në rastin e z. D., pasi ai nuk ka qenë i regjistruar si subjekt tregtar.**
- c. Neni 48/2 të ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, ku parashikohet afati 5-vjeçar për ruajtjen e informacionit kontabël.

³⁹ Shih pyetësorin nr.3

dheut/dhënie me qira. Këto marrëveshje, siç kemi trajtuar më lart, nuk janë deklaruar në organet tatimore si dhe nga këto shoqëri nuk provohet kryerja e pagesave për bashkëshortin e subjektit.

36.1.10 Në përfundim të hetimit të mësipërm subjektit iu kalua barra e provës për këto rezultate hetimi: (i) subjekti nuk provon me dokumentacion provues ligjor të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj në shumën 22,750,000 lekë, (ii) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit duhej të ishte regjistruar në organet tatimore për aktivitetin që ka kryer, (iii) nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. nuk janë deklaruar marrëveshjet e nënshkruara me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk rezultojnë të jenë paguar detyrimet tatimore; (iv) nëse krahasojmë dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit me deklaratën e saj në deklaratën “Vetting” dhe dokumentacionin e depozituar prej saj konstatohen mospërputhje; (v) si rrjedhim i konstatimeve të mësipërme të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk konsiderohen të provuara dhe të ligjshme dhe nuk do të përfshihen në analizë financiare në zbatim të aneksit D/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, (vi) duket se subjekti ka vendosur në favor të shoqërive për të përfituar prej tyre favore në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve fiktive për justifikimin e të ardhurave të bashkëshortit të saj.

36.1.11 Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka pretenduar se bashkëshorti i saj nuk është person i tatuashëm dhe kontratën me dy shoqëritë e ka lidhur si i tillë, si person i patatuashëm. Sipas subjektit person i tatuashëm janë vetëm dy shoqëritë, “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. dhe për pasojë, detyrimin për të paguar tatimet, e kanë këto dy shoqëri. Pasqyrat financiare të tyre janë regjistruar manualisht në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe i janë nënshtruar kontrollit prej kësaj drejtorie. Subjekti gjithashtu pretendon se marrëdhënia midis bashkëshortit të saj dhe dy shoqërive nuk gjendet në sistemin tatimor, sepse nuk është transaksion midis dy personave të tatuashëm. Ndërkohë subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore me palë shoqëritë e mësipërme.

36.1.12 Pas shqyrtimit të shpjegimeve, të pashoqëruara me dokumenta provues, Komisioni konstaton se:

- (i) subjekti nuk provon me dokumentacion provues ligjor të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj në shumën 22,750,000 lekë;
- (ii) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit duhej të ishte regjistruar në organet tatimore për aktivitetin që ka kryer;
- (iii) subjekti nuk provoi pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të saj.

36.1.13 Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioni konkludon se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk konsiderohen të provuara dhe të ligjshme, duke e vënë subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gjerat “a”, “b” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit 84/2016, për rrjedhojë, ato nuk do të përfshihen në analizë financiare.

36.1.14 Gjithashtu, Komisioni konkludon se subjekti nuk provoi në asnjë moment se nuk ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e çështjeve me palë shoqëritë, me të cilat bashkëshorti i saj ka lidhur marrëveshje punësimi.

36.2 Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi se: *“Me deklaratën noteriale nr. *** dt.27.5.2009, z. A.D., deklaroi se i ka kthyer E.D., shumën prej 30.000 USD qysh në shkurt 2006. Kjo hua është marrë në vitin 2005 nga z. A.D.”*

36.2.1 Në lidhje me këtë hua subjekti në DVP/2005 ka deklaruar: *“30 000 USD të dhënë hua nga bashkëshorti tek vëllai me një deklaratë dore, me afat 5 vjet.”* Kur është pyetur nga

Komisioni, subjekti sqaron se burim kanë qenë të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni, por nuk disponon dokumentacion provues.

36.2.2 Në lidhje me burimin e të ardhurave të z. A.D., për shlyerjen e kësaj huaje, subjekti sqaron se ai e prishi marrëveshjen për blerjen e shtëpisë dhe i ktheu po të njëjtat lekë bashkëshortit të saj.

36.2.3 Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.12.2019 të z. A.D., dhe znj. A.D., të cilët deklarojnë se: “...E.D., së bashku me bashkëshorten Nevrie Duka, me kërkesën tonë, na dhanë borxh një shumë 30, 000 USD për të na ndihmuar për të blerë apartament. Por meqenëse nuk plotësonim shumën që na kërkohej nga shitësi...hoqëm dorë nga blerja e një apartamenti të ri, dhe shumën prej 30, 000 USD ia kthyem përsëri atyre që na e dhanë këtë shumë...”

36.2.4 Ndërkohë në deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.05.2009, z. A.D., deklaroi si më poshtë: “Unë, A.D., në muajin shkurt të vitit 2006 i kam dhënë cash në dorë z. E. D...shumën prej 30 000 USD, shumë kjo e marrë hua nga unë prej atij për blerjen e shtëpisë sime në vitin 2005.”

36.2.5 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për këto rezultate hetimi: (i) bashkëshorti i subjektit nuk dokumenton të ardhurat nga emigracioni të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 30, 000 USD; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se bashkëshorti ka përfituar të ardhura nga emigracioni; (iii) subjekti ka paraqitur dy akte noteriale, të cilat nuk përputhen në përmbajtje në lidhje me përdorimin e huas në shumën 30, 000 USD, (iv) subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. A.D., për kthimin e shumës 30, 000 USD.

26.2.6 Në parashtrimet e paraqitura për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, subjekti, megjithëse nuk depozitoi asnjë dokument, ka shpjeguar: (i) të gjitha lekët e përfituara nga emigracioni, bashkëshorti nuk ka qenë i siguar në vendin përkatës të punës, si çdo shqiptar tjetër, por përderisa këto lekë nuk i ka shpallur ligjërisht askush të pavlefshme, këto ne i kemi përdorur; (ii) ju sqaroj se me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2019 është saktësuar se është prishur marrëveshja e A.D., për blerjen e shtëpisë dhe për këtë shkak shuma prej 30, 000 USD na u kthye përsëri.

36.2.7 Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim tjetër dhe as nuk ka depozituar ndonjë dokument provues. Në këto kushte, Komisioni konkludon se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në shumën 30, 000 USD z. A.D., dhe kthimin e saj, duke kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germet “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

36.3 Nga ana e QKB-së informohemi se bashkëshorti i subjektit figuron i regjistruar si person fizik në datën 6.7.2017 me NIPT ***, me adresë lagjja nr. ***, rruga “****”, pallati ***, kati i parë, me aktivitet “restorant”. Statusi aktual i çregjistruar (25.10.2018). Subjekti ka depozituar kontratë qiraje⁴⁰ nr. ***, nëpërmjet së cilës bashkëshorti i saj dhe z. D.K., kanë marrë me qira një ambient me sipërfaqe 124.3 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, ndodhur në zona Turizëm -Kanali i ***, blloku ***, parcela nr. ***.

⁴⁰Administruar dhe me shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2020, të noterit G.N.

36.3.1 Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.05.2018, bashkëshorti i subjektit ka hequr dorë nga vazhdimi i të qenët qiramarrës, duke pranuar që ushtrimi i aktivitetit në të ardhmen të bëhet nga z. D.K., dhe djali i tij A.K. Me heqjen dorë, ai ka përfituar shumën 10, 000 euro nga shtetasit e mësipërm, e cila provohet me mandat bankar të “Credins Bank” të datës 17.5.2018.

36.3.2 Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e të ardhurave të z. D.K., për dhënien e shumës 10, 000 euro. Në përgjigjen e saj ajo nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. D.K.

36.3.3 Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës: (i) për të provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. D.K., për dhënien e shumës 10, 000 euro; (ii) të provojë me dokumentacion provues vlerën e investimit të bashkëshortit të saj.

36.3.4 Subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të saj të mëparshme, duke sqaruar se të ardhurat e z. K., janë nga kursimet e tyre familjare. Në seancën dëgjimore ajo rishpjegoi se z. K., duke qenë kuzhinieri më i mirë i peshkut në Sarandë, sigurisht që i ka patur mundësitë për të kursyer këtë shumë. Por subjekti nuk ka provuar me dokumentacion as investimin e bashkëshortit të saj dhe as mundësitë financiare të z. K.

36.3.5 Komisioni pasi dëgjoi shpjegimet e subjekti vlerëson se ajo nuk justifikoi me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. K., për shumën 10, 000 euro.

37. Në lidhje me likuiditetet

Nga përgjigja⁴¹ e “Procredit Bank” rezulton se:

37.1 Në llogarinë në lekë të subjektit janë kryer lëvizjet e mëposhtme:

37.1.1 Në datë 4.3.2008 z. E.D., i ka transferuar shumën 1, 288, 665.37 lekë tek z. A.O. Është pyetur subjekti në lidhje me transferim. Në përgjigjen e saj ajo deklaroi se nuk i kujtohet arsyeja e transferimit.

37.1.2 Pasi iu kalua barra e provës në lidhje me arsyet e transferimit të shumës 1, 288, 665.37 lekë tek z. A.O., subjekti ka shpjeguar se: “...nëse shuma e mësipërme është transferuar te A.O., sot ky shtetas nuk ka asnjë detyrim, që do të thotë se e ka kthyer.”

37.1.3 Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të qartësojë me shpjegimin e saj këtë transferim të shumës 1, 288, 665.37 lekë, duke kryer deklaram të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germa “a” dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

37.2 Në datë 12.6.2009 z. E.D., ka transferuar shumën 2, 482, 000 lekë tek z. B.K. Në lidhje me këtë transferim, subjekti sqaroi se shuma përfaqëson shumën e shitjes së apartamentit në pronësi të motrës së saj pas heqjeve të taksave.

37.2.1 Rezulton nga dokumentacioni se në datë 4.8.2008, me kontratë shitblerjeje nr. ***, subjekti, në cilësinë e përfaqësues së z. B.K., dhe znj. L.K., ka shitur apartament, me sipërfaqe 56 m², në shumën 1, 696, 184 lekë.

⁴¹Kthim përgjigjeje “Procredit Bank” nr. ***, datë 20.12.2019

37.2.3 Duke qenë se subjekti ka deklaruar se shuma e transferuar prej 2, 482, 000 lekë është çmimi i shitjes së shtëpisë së motrës së saj, ndërkohë që bazuar në kontratën e shitjes ky çmim është 1, 696, 184 lekë, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar arsyet e kësaj mospërputhjeje. Ndërkohë që diferenca midis shumës 1, 696, 184 lekë dhe shumës 2, 482, 000 lekë është përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, si shpenzim.

37.2.4 Në parashtrimet e saj, subjekti sqaron se shuma e padeklaruar i përket motrës që është rezidente në Angli. Për shkak të mungesës së rubrikës në deklarimet DVP, subjekti shpjegon se nuk e ka deklaruar, sepse nuk e ka konsideruar si një vlerë që i përket asaj vetë, por motrës së saj.

37.2.5 Shpjegimet e subjektit nuk qartësojnë mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni, si dhe diferencën midis çmimit të shitjes së apartamentit të motrës së subjektit me shumën që i është transferuar asaj. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të paplotë, të rremë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “ç”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

37.3 Nga nxjerrja e llogarisë në USD të bashkëshortit, rezulton se në datë 23.6.2006, subjekti ka depozituar shumën 20, 000 USD në “Procredit Bank”.

37.3.1 Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për depozitimin e kësaj shume.

	23.6.2006
PASURI	2 519 171
Depozitim i shumës 20,000 USD	2 474 060
<i>Shtesa/Pakësime likuiditeteve</i>	<i>45 111</i>
Likuiditete gjendje	216 632
TË ARDHURA dokumentuar	30 346
Të ardhura nga paga e subjektit	30 346
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0
SHPENZIME	7 804
Shpenzime jetese	7 804
Mundësia për kursime	-2 496 629

37.3.2 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më sipër, duke përfshirë tek të ardhurat edhe ato të siguruara nga bashkëshorti.

37.3.3 Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshëm depozitimin e shumës 20, 000 USD në vitin 2006, duke kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

37.4 Nga hetimi ka rezultuar se nga kjo llogari:

- Në datën 29.1.2007 znj. P.O., i është transferuar shuma 5, 000 USD;
- Në datën 2.4.2009 z. A.O., kalon shumën 6, 600 USD;
- Në datën 28.4.2009 z. A.O., kalon shumën 6, 000 USD;
- Në datën 11.6.2009 z. A.O., kalon shumën 13,345 USD.

37.4.1 Në lidhje me transferimet e z. O., subjekti deklaron se shumata e transferuara nga z. O., është shuma e konvertuar në USD e çmimit të shitjes së apartamentit të motrës së saj. Ky deklarami i subjektit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar, pasi shuma e transferuar nga z. O., është 25, 945 USD, (2, 438, 311 lekë⁴²) shumë e cila nuk përputhet me çmimin e shitjes së apartamentit. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin provues për të provuar deklaramet e saj.

37.4.2 Duke qenë se subjekti nuk arriti të qartësojë këto transferta nëpërmjet pyetësorit të bërë nga Komisioni, në përfundim të hetimit, iu kalua barra e provës për këto rezultate të hetimit: (i) deklarami i subjektit të rivlerësimit në lidhje me transferimin e shumës 25, 945 USD nga z. A.O., nuk përputhet me dokumentacionin e administruar, pasi apartamenti është shitur në shumën 1, 696, 184 lekë, duke e vënë subjektin në kushtet e deklaramit të rremë; (ii) subjekti nuk provon me dokumentacionin kalimin e shumës në lekë nga bashkëshorti tek z. A.O., me qëllim këmbimin e tyre.

37.4.3 Në parashtrimet e saj, subjekti nuk ka sqaruar asgjë në lidhje me këtë rezultat të hetimit, duke referuar në shpjegimin e dhënë prej saj se këto para i përkisnin motrës së saj.

37.4.4 Komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës në lidhje me transferimin e shumës 25, 945 USD nga z. A.O., tek bashkëshorti i saj, ajo ka kryer deklaram të paplotë, të rremë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gjerat “a” dhe “ç”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

38. Në lidhje me DVP-të

38.1 Në DVP/2004 subjekti ka deklaram si më poshtë:

- a. Autoveturë në emër të bashkëshortit 200, 000 lekë;
- b. Depozitë bankare 13, 004 USD;
- c. Depozitë bankare 550, 000 lekë.

ILDKPI në lidhje me këto depozita ka konstatuar:

➤ *Mungesë e dokumentacionit ligjor që ka shërbyer për depozitat në vitin 2004 në vlerë totale rreth 2.206.000 lekë, pasi referuar deklaramtës së interesave private para fillimit të detyrës 2003, subjekti nuk ka deklaram gjendje cash.*

38.1.1 Në lidhje me autoveturën e bashkëshortit, ajo është blerë në datën 2.4.2004 në shumën 250,000 lekë, e përfshirë në analizën financiare.

○ Nga lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se në prill 2005, janë mbartur nga viti 2004 teprica në shumën 559,681.55 lekë, shumë e cila përputhet me deklaramin e subjektit për depozitat në lekë.

Kjo shumë është përfshirë në analizën financiare si gjendje likuiditetesh për vitin 2004.

○ Ndërsa nuk ka asnjë gjurmë të ndonjë depozitë në dollarë për subjektin, bashkëshortin apo në llogari dyemërore. Madje nuk rezulton asnjë tërheqje apo mbyllje e kësaj depozitë në vitin 2006, sikurse deklaram nga subjekti në DVP/2006.

⁴²Kusi i këmbimit 1 USD = 93.98 lek, Banka e Shqipërisë 31.12.2009

Kjo depozitë⁴³ nuk është përfshirë në analizën financiare të vitit 2004 dhe nuk konsiderohet si burim për blerjen e skrepit nga bashkëshorti, sikurse deklaruar në DVP/2006.

	2004
PASURI	855 401
Makinë “Benz” 300D në pronësi të bashkëshortit	250 000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>605 401</i>
Likuiditete gjendje	605 401
TË ARDHURA dokumentuar	814 471
Të ardhura nga paga e subjektit	814 471
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	0
SHPENZIME	214 543
Shpenzime jetese	187 928
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	26 615
Mundësia për kursime	-255 473

38.1.2 Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të blerë automjetin dhe për të krijuar gjendjen e likuiditeteve në lekë, gjatë vitit 2004. Për këtë iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati.

38.1.3 Në përgjigje të barrës së provës subjekti shprehet: *“Ju duhet të verifikoni edhe një herë bankën në lidhje me pretendimin për depozitën. Ju sqaroj se për këtë vit, ashtu siç ju kam sqaruar më sipër, i kam patur mjetet monetare për blerjen e makinerisë”*.

38.1.4 Subjekti nuk paraqiti asnjë dokument për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit të Komisionit duke mos justifikuar me burime të ligjshëm blerjen e automjetit dhe krijimin e likuiditeteve për vitin 2004. Komisioni vlerëson se ajo ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, geramat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

38.2 Në DVP/2005 ka deklaruar: “3000 paund të dërguara nga motra si borxh i pashlyer ndër vite ndaj meje.”

ILDKPI në lidhje me këtë hua ka konstatuar:

➤ *Mosdeklarim në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2003 i huas dhënë motrës, në vlerën 3.000 paund.*

38.2.1 Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar këtë hua në DVP/2003⁴⁴. Në parashtrimet e saj, por edhe në seancë dëgjimore, subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar kthimin e kësaj huaje nga motra e saj, por dhënia e kësaj huaje nuk është deklaruar meqënëse ajo i ka dhënë motrës herë pas here shuma të vogla, sipas nevojave, dhe të gjitha këto shuma i janë kthyer përsëri njëherësh.

⁴³Trajtuar gjerësisht në pikën 35.3 të këtij vendimi.

⁴⁴Shuma 3,000 paund është përfshirë si borxh kumulativ në analizën e “Deri në vitin 2003” dhe në vitin 2005 si kthim borxhi, sikurse deklaruar.

38.3 Në DVP/2008, subjekti ka deklaruar: “Shuma prej 35, 734 USD iu dha hua z. L.S., për 1 vit.” Në lidhje me këtë hua subjekti në DVP/2009 deklaroi se u kthye shuma së bashku me interesat në vlerën 39, 307 USD.

ILDKPI në lidhje me këtë hua ka konstatuar:

➤ *Mosdeklarim në deklaratën e pasurisë “Vetting”, i të ardhurave nga interesat e huadhënies në vitin 2008 dhe mungesë dokumentacioni justifikues në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga interesi i huadhënies.*

38.3.1 Në lidhje me burimin e dhënies së huas subjekti ka deklaruar se është nga shitja e truallit në shumën 70, 000 euro. Nga hetimi⁴⁵ ka rezultuar se në datë 4.3.2008 me kontratë huaje nr. *** prot., bashkëshorti i subjektit i ka dhënë hua me interes 10% për 1 vit z. L.S., shumën 35,734 USD.

38.3.2 Konstatohet se burimi i të ardhurave për dhënien e huas z. S., nuk mund të kenë qenë të ardhurat e siguruar nga shitja e truallit, pasi ato, bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 28.5.2008 janë marrë në datën 26.5.2008. Gjithashtu, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*, ajo nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

38.3.3 I është kërkuar subjektit të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. S., për kthimin e huas, si dhe për çfarë e ka përdorur ajo shumën 39, 307 USD. Subjekti në përgjigjen e saj ka deklaruar se nuk e kujton se për çfarë e ka përdorur shumën 39, 307 USD, si dhe nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për të ardhurat e z. S.

38.3.4 Meqënëse nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk i kishte mjetet financiare për dhënien e kësaj huaje, meqënëse subjekti nuk ka provuar me dokumentacion mundësitë financiare për shlyerjen e huas të huamarrësit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën. Gjithashtu subjektit iu kalua barra e provës edhe për faktin se deklaratimet e subjektit në lidhje me burimin e dhënies së huas nuk përputhen me dokumentacionin e administruar, duke e vënë subjektin në kushtet e deklaratimit të rremë. Trualli i shitur, i pretenduar si burim për huan, është shitur dy muaj më vonë nga dhënia e huas.

38.3.5 Subjekti ka parashtruar se i ka patur mundësitë për dhënien e kësaj huaje për arsyet e paraqitura më sipër, pa specifikuar më tej. Ndërsa për mundësitë për shlyerjen e huas nga huamarrësi, subjekti thjesht ka sqaruar se për shkak të biznesit privat/pastiçeri, të huamarrësit, prezumon se i ka patur mundësitë.

38.3.6 Komisioni konkludon se subjekti dështoi të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit, duke mos depozituar asnjë dokument për të provuar burimin e ligjshëm për dhënien e kësaj huaje, si dhe kthimin e saj, duke kryer deklaratim të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germa “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu subjekti ka kryer deklaratim të rremë në lidhje me burimin e huas.

38.4 Në DVP 2015, subjekti deklaroi: “Shuma 15, 000 euro i është dhënë hua vëllait të bashkëshortit G.D., për një afat trevjeçar për nevoja të kompletimit të objektit që ka ndërtuar në zonën Turizëm - Kanali i ***.”

⁴⁵Shih shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2020, të ILDKPI-së.

ILDKPKI-ja në lidhje me këtë hua ka konstatuar:

- *Mosdeklarim në deklaratën e pasurisë “Vetting” i huas dhënë në vitin 2015 shtetasit G.D., (vëllai i bashkëshortit) në vlerën 15.000 Euro.*

38.4.1 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, bazuar në analizën financiare, subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas z. G.D. Për këtë rezultat të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës.

38.4.2 Subjekti në përgjigje të barrës së provës, ka shpjeguar se e ka deklaruar këtë hua në DVP 2015, por për shkak të ngarkesës në punë, thjesht ka harruar ta deklarojë në deklaratën “Vetting”. Ndërsa në lidhje me mundësitë financiare për huadhënien, subjekti i është referuar përsëri shpjegimeve të mëparshme për të ardhurat familjare.

38.4.3 Komisioni vlerëson se, pavarësisht se nuk ka kaluar shumë kohë nga dhënia e kësaj huaje, si dhe shuma nuk është shumë e vogël për t’u harruar, subjekti duhet të ishte treguar i kujdesshëm në detyrimin e saj kushtetues për të plotësuar me saktësi deklaratën “Vetting”, por Komisioni pranon shpjegimin e subjektit se kjo është pasaktësi që nuk ka patur për qëllim fshehjen. Në lidhje me mundësitë financiare për dhënien e kësaj huaje, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshëm, dhënien e huas në shumën 15, 000 euro z. G.D.

39. Analiza Financiare⁴⁶

39.1 Në Tabelën më poshtë është pasqyruar një përmbledhje e analizës financiare për të gjithë periudhën, nga fillimi i detyrës për subjektin e rivlerësimit. Pamundësia financiare totale e subjektit për të krijuar pasuritë dhe për të mbuluar shpenzimet është -17 419 034 lekë (*Totali i viteve negative*). Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat negativ.

<i>Vitet</i>	<i>Të Ardhura</i>	<i>Shpenzime</i>	<i>Pasuri</i>	<i>Detyrime</i>	<i>Mundësia për Kursime</i>
<i>deri 2003</i>	2,850,113	776,757	857,760		1,215,596
2003	615,515	93,964	0		521,551
2004	814,471	214,543	855,401		-255,473
2005	839,861	443,682	3 765 489	873,968	-2 495 343
2006	730,404	388,736	3,797,165	-800,569	-4,256,066
2007	670,204	455,605	19,689	-73,399	121,511
2008	801,933	394,352	1 861 422		-1 453 841
2009	415,544	1,110,289	-3,066,115		2,371,371
2010	876,855	1,188,621	301,619	659,514	46,128
2011	1,080,444	534,509	6,097,755	-62,191	-5,614,012
2012	1,145,815	704,689	1 074 818	75,431	-558 261
2013	1,225,336	521,845	957,615	-238,981	-493,105
2014	1,594,820	1,371,600	1,674,305	-228,447	-1,679,532
2015	1,555,478	1,132,315	355,602	-115,426	-47,865
2016	1,493,245	1,055,625	913,258	-89,900	-565,537
Totali	16,710,037	10,387,133	20,785,542	0	-13 142 878

⁴⁶ Në lidhje me metodologjinë, lutemi referojuni dokumentit “Rezultatet e hetimit” dërguar subjektit të rivlerësimit.

39.2 Komision konkludon se subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme mbulimin e shpenzimeve gjatë periudhës së rivlerësimit, duke kryer deklaram të paplotë, pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germat “a” dhe “b”, si dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE

40. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të subjektit Nevrie Duka (Halo) për kriterin e pasurisë, Komisioni vlerëson se:

- (i) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pika 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germat “a” dhe “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;
- (ii) subjekti ka kryer deklaram të rremë në kuptim të nenit 33/5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016;
- (iii) subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshëm blerjen e pasurive të luajtshme apo të palujatshme nga ana e saj apo e personave të lidhur me të, dhënien e huave nga ana e saj apo e personave të lidhur me të tek të tretët, aftësinë financiare të të tretëve për kthimin e huave, krijimin e likuiditeteve nga ana e saj apo e personave të lidhur me të, si dhe mbulimin e shpenzimeve nga ana e saj apo e personave të lidhur me të për periudhën e rivlerësimit;
- (iv) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 33/5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016;
- (v) subjekti nuk paraqiti prova si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të saj, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

41. Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, referuar pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe standardit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimi për subjektin e rivlerësimit është marrë bazuar vetëm në kriterin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Nevrie Duka.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 12.3.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Olsi KOMICI
Anëtar

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Fiorela MANDRO